

VENDIM
Nr. 570, datë 3.9.2014

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME, PËR PROGRAMIN “SHËRBIMI I
GJENDJES CIVILE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.1998, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Shërbimi i Gjendjes Civile”, t’i shtohet fondi 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit të konsulencës së projektit “Ndërtimi i sistemit të ruajtjes së informacionit dhe vazhdueshmërisë së punës së Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës për vitin 2014.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama